

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E ENJTE 9 MAJ 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Përgjatë javës së fundit kemi ndjekur përditë me radhë protestën në Rinas. Autoriteti Rrugor Shqiptar në datën 1 maj vuri në fuqi urdhrin për një sens kalimi në aksin Qafë-Kashar – rrethrotullimi “Nënë Tereza” - Ahmetaq. Pavarësisht se ky urdher u paraqit me idenë se do të lehtësonte trafikun kilometrik për udhëtarët, të cilët udhëtojnë drejt aeroportit “Nënë Tereza”, ai pati një efekt bumerang për banorët e Rinasit, dhe jo vetëm. E them këtë, sepse bashkë me banorët e Rinasit i jemi drejtuar qeverisë për ditë me radhë me thirrje për rishikim të një vendimi të pabazë e të pamenduar, që ishte penalizues për banorët e Rinasit, zonës së Fushë-Krujës e më tej. Nuk e kuptoj si merren dhe ku bazohen të tilla vendime? A janë bërë konsultime publike? A është bërë një analizë e thellë se çfarë do të bëhej me kostot shtesë që do të kishin këta banorë me këtë lëvizje? Unë mendoj se përgjigjja për këto pyetje është: jo, nuk ka pasur asnjë analizë dhe asnjë konsultë publike, sepse, nëse do të kishte pasur të tillë procedurë, do të kishte patjetër një tjetër menaxhim. Gjatë ditëve të protestës, bashkë me banorët e Rinasit, në mesin e të cilëve kishte edhe fëmijë të mitur, zonja e zotërinj, të cilët luftonin për të drejtat e tyre, pa u angazhuar në asnjë cenim të uniformave policore, ne dëshmuam dhunën policore.

Nuk mund të lë pa thënë se ky fakt është jo vetëm i pamohueshëm, por edhe i patolerueshëm. Si deputete e dënoj çdo lloj akti dhune, sidomos kur ajo dhunë vjen nga uniformat e policisë. Gjithashtu, gjatë protestës së Rinasit u evidentua nevoja urgjente për investime infrastrukturore. Rrugët e sugjeruara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar si rrugë alternative për banorët, janë të amortizuara, të ngushta dhe nuk kanë as trotuar. Rrugët që rrethojnë aeroportin janë po në atë gjendje. Kjo zonë nuk ka pasur investime prej vitesh. Nëse e patë, shkolla “Rexhë Deliu” është ende në kushtet që e ka lënë komunizmi, nuk ka asnjë fushë sportive, pavarësisht se ka hapësirë për t’u investuar. Kam disa pyetje për Ministrinë e Infrastrukturës dhe ARRSH-në për zgjidhjen që do t’i jepet aksesit drejt aeroportit. Me sa jemi në dijeni, do të ketë një tjetër rrugë që do ta lidhë aksin kryesor me hyrjen e re të aeroportit. A do të ketë shpronësime? A do të ketë konsulta publike dhe analiza të thella mbi vendimet që do të vijojnë? Pse nuk ka një projekt të mirëfilltë për zgjerimin e rrugës? Pse jepet një rrugë alternative e tillë dhe pse nuk ka projekte që duhet t’i japin autoritetin dhe prioritetin një institucioni, që është porta hyrëse për në Shqipëri? Dua të them se nevojë për investime ka edhe në rrugë të tjera të njohura, si rruga e Urës së Tubit, e cila ka nevojë për investime të menjëhershme, sepse ka impakt për të gjitha fshatrat përreth. E gjitha zona ka nevojë për projekte serioze ambicioze mbi investimet infrastrukturore rrugore. Shpeshherë në këtë foltore kam rrëfyer se jeta në zonën e Fushë Krujës po bëhet çdo ditë e më e vështirë. Ka vështirësi ekonomike dhe sociale, mungesa në investime gjithëpërfshirëse, mungesë të mbështetjes për fermerët, rritje të emigracionit. Fshatrat tanë po boshatisen dita-ditës, por ky parlament dhe kjo qeveri nuk po tregon seriozitetin e duhur. Çfarë mund të bëjmë ne për këtë? Çfarë mund të bëjmë ne për rinjtë e Fushë Krujës të Niklës, të Bubqit? Po në Krujë? Po në qarkun e Durrësit çfarë mund të ofrojmë ne? Pushteti lokal nuk ka investuar në asnjë

hapësirë publike, në asnjë fushë sporti. Nuk ka parqe, nuk ka kënde lojërash për fëmijë. Zona e Fushë Krujës dhe e Niklës, e cila duhej të ishte cilësuar kohë më parë si një zonë me industri të avancuar, nuk ka asnjë investim që u vjen në ndihmë banorëve. Në një rrugë nacionale, që nuk ka ndriçim, ka aksidente dhe trafik të dendur, cila do të ishte një zgjidhje? Nëse do të më pyesnit mua, duhej të kishte patjetër investime në arsimin profesional. Kjo do të ishte një alternativë për të pasur më shumë punësime në këtë zonë, nga çdo i ri i zonës. Kjo do të sillte një frenim të një pjese të të rinjve që i drejtohen Tiranës për punë dhe më tej Europës. Ka 8 vjet që pallatit të kulturës në Fushë Krujë i është vënë kyçi. Nuk ka aktivitete rinore, nuk ka frymëzim për artdashësit. Pse? Pse nuk ka programe për të rinjtë? Pse nuk ruhen monumentet tona kulturore? Pse nuk mirëmbahen ura e Abdyl Agës, ura e Kurtsait, kalaja e Zgërdheshit? Po biblioteka publike e Fushë Krujës pse nuk funksionon më? A mund t'u ofrohet një qytet i pastër këtyre banorëve? Patjetër që jo, sepse ne kemi evidentuar që në zonën e Fushë-Krujës nuk ka kosha plehrash në rrugët e qytetit, për të mos thënë që banorëve u digjen plehurat në pragun e shtëpisë së tyre. Ky është një qytet pa asnjë spital, një zonë pa investime në shëndetësi. Nuk ka asnjë dokument ku të thuhet se urgjenca e Fushë Krujës përmbush parametrat e një urgjence normale.

Qeveria ka sugjeruar se në kohë të vështira si këto duhet të kursejmë edhe energjinë elektrike. Po çfarë mund të kursesh kur këto fshatra as nuk furnizohen 24 orë me energji elektrike? Ka ndërprerje të shpeshtë të energjisë në Qerekë dhe Tapizë të komunës Nikël. Të tjera probleme si këto shtrihen në të gjithë zonën. Gjithashtu, dua të sjell në vëmendjen tuaj se zona e Bubqit vazhdon të përmbetet nga neglizhenca e pastrimit të kanaleve kulluese.

Në dimër në këtë zonë përmbysten dhe në verë thahen të mbjellat nga mungesa e ujit. Do të doja të mendoja se pushteti lokal nuk është në dijeni për këto problematika, por jo, ata dhe patronazhistët e tyre, që survejojnë çdo votë që hidhet në kuti, i kanë listuar këto probleme që në vitin 2013 e më tej në vitin 2015. Problemi qëndron te mungesa e dëshirës së pushtetit lokal dhe atij qendror për të vepruar. Propaganda duhet të mbarojë, sepse qytetarët e dinë kush është në anën e tyre. Një qeveri, cila lejon që vendi të zbrazet nga potenciali i saj, është thjesht ilegjitime. Faleminderit!